

## **Irena Binjaku - Keshilltare**

Mban pozicionin e Këshilltares së Ministrisë të Drejtësisë, që nga muaji Tetor 2021.

Është pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme, kategoria "Asistent-Lektor", pranë Departamentit të së Drejtës Civile në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, miratuar në Shkurt 2022.

Prej vitit 2016 është angazhuar si asistent lektore pranë Fakultetit të Shkencave Juridike në Universitetin Europian të Tiranës, në lëndët e së drejtës private si: "E Drejta e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore" dhe "E Drejta Familjare". Ndërsa në periudhën 2015-2016 ka mbajtur pozicionin e juristes në Drejtorinë e Përfitimeve, pranë Insitutit të Sigurimeve Shoqërore. Në vitin 2013 është diplomuar si juriste, dhe në vitin 2015 ka përfunduar studimet Master Shkencor me profil e Drejtë Private, në Universitetin Europian të Tiranës me rezultate të shkëlqyera, Është licensuar si avokat në vitin 2016 nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjithashtu ka publikuar artikuj të ndryshëm në revista shkencore brënda dhe jashtë vendit, si dhe ka marrë pjesë në një sërë konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Zotëron gjuhët angleze dhe italiane.

**Fusha e angazhimit:** Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën civile dhe penale; Mbikqyrje e Agjencisë së Trajnimit të Pronave; Shërbimi Përmbarimor; Shërbimet dhe profesionet e lira.